



KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

Procesverbal i mbajtur më 08 shtator 2020, në mbledhjen e XXVIII-të (njëzet e tetë) mandati VI, të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit, ndërtesa e re e Komunës, kati përdhes, dhe filloi në orën 10:05.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, përkatësisht kryesues i këtij Komiteti.

Fillimisht u konstatua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti: Mehmet Gashi, Arlinda Kadriu, Fatlume Jaha, Adelinë Stublla, Rafet Llapashtica, Endritë Murati, Patriot Rudari dhe Vendenis Lahu. Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje të pranishëm ishin; Gëzim Namani, Drejtor i Drejtorisë së Administratës-DA, si dhe Hamdi Jaha, Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit – DPUMM.

Rendi i ditës

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Komitetit, e hapi mbledhjen duke i përshëndetur të pranishmit, ndër të tjera shtoi, besoj që thirrjen dhe materialin për këtë mbledhje e keni marrë të gjithë me kohë, kështu që mund fillojmë me punë në këtë takim, andaj urdhëroni nëse dikush dëshiron fjalën.

z.Hamdi Jaha, drejtor i DPUMM, theksoi, dëshiroj të paraqes një kërkesë të Komitetit të Sporteve dhe Krijuesve të Trevës së Llapit e cila ka të bëjë me shtatoren e legjendës së futbollit Kosovar Fadil Vokrri, kërkesë të cilën kemi menduar ta fusim si pikë shtesë të rendit të ditës në KPF fillimisht, pastaj për të vazhduar tutje në mbledhjen e Kuvendit që do të mbahet nesër. Kjo për shkak se kërkesa ka ardhë me vonesë ngase Komiteti i Sportistëve, faktikisht punimin e Shtatores së Fadil Vokrrit veç se e kanë në përfundim dhe ne si Komunë kërkohet ta caktojmë vendin/lokacionin se ku do të vendoset ajo andaj kjo është kërkesa jonë dhe besoj që edhe ju anëtarët e KPF-së do ta merrni për bazë këtë për shkak se edhe si kërkesë ka ardhë me vonesë dhe ne nuk kemi mund ta fusim si pikë të rregullt në kuadër të rendit të ditës.

z.Vendenis Lahu, theksoi, lidhur me çështjen në fjalë nuk po e kam shumë të qartë dhe nuk e shohë shumë të arsyeshme pse duhet të procedohet me kaq nguti një kërkesë që paska ardhë me vonesë, pra nuk po e kam shumë të qartë se cila është arsyeja e procedimit me kaq nguti dhe kaq shpejtësi si dhe cilat shoqata ose klube të sportit e kanë adresuar këtë kërkesë zotëri drejtor.

Pyetja ime është se a është kjo kërkesa e vetme që keni pasë deri më tani për një çështje të tillë apo keni pasë edhe kërkesa tjera të cilat i keni shqyrtuar ose jo, dhe a mund të na njoftoni rreth kërkesave tjera që kanë të bëjnë jo vetëm me figurat sportive por edhe me figurat kombëtare.

z.Patriot Rudari, theksoi, kërkoj që në kuadër të rendit të propozuar të ditës të futet edhe një pikë shtesë, informatë për arsimin, sepse prindërit dhe fëmijët vazhdimisht po pyesin se në cilin variant do të fillojë procesi mësimor. Kjo edhe për faktin që përmes mjeteve të informimit po dëgjojmë se shumë komuna kanë jap informacione për arsim se në cilin variant do të fillojë procesi mësimor qoftë varianti

A, B apo C, shembull, në shkollat e mesme dhe fillore se si do të organizohet procesi mësimor qoftë në qytet apo fshatra, kur dihet mirë se numri i nxënësve në fshatra është më i vogël, andaj është mirë që drejtori i Drejtorisë së Arsimit të na japë një informatë rreth fillimit të procesit mësimor në nivel të Komunës së Podujevës.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Komitetit, theksoi, kemi propozimin e Drejtorit të DPUMM z.Hamdi Jaha, për futje edhe të një pike shtesë në rend të ditës sipas asaj që e paraqiti, gjithashtu kemi edhe propozimin tjetër të z.Patriot Rudari po ashtu për pikë shtesë, Informata për fillimin e vitit të ri shkollor, informatë e cila ka qenë edhe me plan të punës për sot dhe ja kam rikujtuar paraprakisht drejtorit të Drejtorisë së Arsimit, edhe pse ai në mbledhjen e kaluar të Kuvendit ka pasë temë rreth arsimit mirëpo në kohën kur materialet veç ishin në procedim e sipër për këtë mbledhje të KPF-së respektivisht të Kuvendit të Komunës, nuk ishim të informuar nga niveli qendrorë se kur do të fillojë procesi mësimor drejtori i DKA-së e ka parë më të arsyeshme që në seancën e radhës të Kuvendit ta paraqet një informatë të tillë më të detajuar rreth fillimit të vitit të ri shkollor si dhe për çështje tjera në Arsim, kështu që në mbledhjen e nesërme të Kuvendit është prezent drejtori i DKA-së dhe konsideroj që këtë pyetje mund të ia parashtroni edhe atij nesër dhe ndërkohë të na paraqitet një njoftim i tillë rreth përgatitjeve, formave, metodave, planeve dhe strategjive të kërkuara nga këshilltari parafolës z.Patriot Rudari, mirëpo për një informatë siç u kërkuar konsideroj se është shumë kohë e shkurtë të përgatitet për nesër por si do që të jetë besoj që nga Drejtori i Drejtorisë së Arsimit do të kemi informatë për të gjitha çështjet.

z.Hamdi Jaha, drejtor i DPUMM, theksoi, faktikisht gjatë kësaj periudhe kohore nuk kam pasë kërkesë tjetër përveç një kërkesë që ka qenë vendosja e Simbolit të Shqiptonjës në pjesën e rrugës magjistrale Podujevë-Prishtinë, çështje e cila nuk ka qenë në kompetencën time respektivisht DPUMM-së sepse ajo faktikisht është dashur të kalojë në Kuvend, edhe pse është vendosur tash më.

z.Vendenis Lahu, theksoi, sqarim për drejtorin e DPUMM z.Hamdi Jaha, një vit para se të vendoset Simboli i Shqiptonjës ka qenë një kërkesë lidhur me emërtimin e shëtitores që ta ketë emrin e Heroit të popullit simbolit të rezistencës Kombëtare Adem Demaçi, për këtë çështje unë kam biseduar me ju në zyrën e juaj, dhe këtë çështje LVV në Kuvend Komunal e ka paraqitur si kërkesë, andaj me këtë rast kërkoj sqarim se çfarë ka ndodhë me këtë kërkesë.

z.Hamdi Jaha, DPUMM, sqarim parafolësit, theksoi, i nderuar unë ju tregova që vetëm një kërkesë ka ardhë te unë si drejtor i DPUMM, kërkesë tjetër nuk kam pasë, është e vërtetë që ne kemi biseduar lidhur me kërkesën që ju keni shtruar, por nuk ka qenë kërkesë që më është adresuar mua, andaj sqarimet mund t'i kërkonin në Kuvendin e Komunës lidhur me kërkesën në fjalë sepse mua nuk më është adresuar ajo kërkesë sepse kanë qenë dy kërkesa, ajo që është vendosur Simboli i Shqiptonjës, e që është vendosur ilegalisht sepse nuk e ka marrë fuqizimin/miratimin, mirëpo është në pyetje për një Simbol të Kombit dhe unë kam heshtur në këtë çështje për shkak se njerëzit dëshirojnë të përfitojnë në aspektin politik por unë nuk kam dashur.

Kjo kërkesë që më është adresuar dhe të cilën e paraqita paraprakisht është për vendosjen e Shtatores së legjendës së Futbollit Kosovar Fadil Vokrri, e që është sportisti më i madh në historinë e Kosovës që ka pasë ndonjëherë, kontributin e tij në UEFA dhe FIFA si dhe punët dhe aktivitetet tjera për internacionalizimin e sportit të Kosovës, me theks futbollit.

Pra mua më është adresuar kërkesa për vendin/lokacionin ku do të vendoset Shtatorja në fjalë.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, sa i përket kërkesës për vendosjen e shtatores së legjendës së Futbollit Kosovar Fadil Vokrri në Komunën e Podujevës mendoj që duhet të kalojë kjo kërkesë, jo pse e parashtron dikush qoftë nga pozita apo opozita, por për shkak të figurës së Fadil Vokrrit dhe kontributit që ka dhënë në sportin Kosovar, e që ka ngecë aty ku e ka lënë ai, pastaj edhe për faktin që është Llapjan por që me suksese dhe kontribut ka tejkaluar përmasat e tij nga Podujeva, Kosova dhe më gjerë.

Sa i përket përcaktimit të lokacionit ku do të vendoset shtatorja e Fadil Vokrrit mendoj se i takon organeve kompetente që ajo shtatore të vendoset në një vend ku qyteti i Podujevës të duket më mirë, qoftë në urbanizëm, qoftë sa i përket pamjes së shtatores apo frekuentimit të qytetarëve dhe i cili do të jetë një lloj frymëzimi për sportistët e rinjë dhe sportistët e ardhshëm.

Sa i përket kërkesës që z.Vendenis Lahu e paraqiti për figurën e Adem Demaçit, mendoj që secili nga ne formën e futjes në proces duhet të kalojnë në procedurë administrative, unë nuk po hipnotizojë se a keni biseduar me drejtorin e DPUMM z.Hamdi Jaha apo me dikë tjetër por unë mendoj që duhet të ekzistojë dokumenti dhe të deklaroni se e keni bërë këtë kërkesë i nderuari Kryesues ose ju Drejtor si dhe e kam ngritë në Kuvend si dhe e kam kërkesën me shkrim që është e protokolluar, pra është çështje e secilit nga ne se a marrim përgjegjësi apo jo, sa kam njohuri unë punimet e shtatores kanë përfunduar dhe ajo është e gatshme andaj pritet miratimi nga ana jonë se ku do të vendoset. Shtatorja e Fadil Vokrrit duhet të vendoset në Llap sepse ai është i këtij vendi, prandaj ne nuk duhet të merremi me pika të cilat i tejkalojnë edhe përmasat e subjekteve politike, secilit nga ne që jemi këtu, kjo pikë duhet të kalojë dhe është qëndrim individual, kështu që unë e mbështes vendosjen e shtatores së Fadil Vokrrit në Podujevë. Sa i përket lokacionit ndoshta në seancën e nesërme do të vendoset në Kuvend, ne si KPF i japim shtytje por Kuvendi vendos, ndoshta dikush mund të jetë kundër vendosjes së shtatores por unë s’paku si anëtar i KPF-së jam për që të futet si pikë e rendit të ditës dhe të shikojmë qëndrimin e secilit.

z.Vendenis Lahu, theksoi, faleminderit zotëri Kryesues për mundësinë që gjithmonë na e jep me shprehje atë që mendojmë dhe dëshirojmë ta shprehim. Mendoj se është krijuar një keqkuptim dhe nuk e di pse, ne nuk pyetëm se kush ka qenë Fadil Vokrrit sepse e njohim, e dim kontributin e tij dhe të gjitha cilësitë dhe veçoritë që ai ka pasë, ne jemi të mendimit që është ide e mirë që të vendoset shtatorja e tij sepse siç e ceku edhe z.Rafet Llapashtica, ai i kalon përmasat e Llapit. Ne nuk kemi kurrfarë vërejtje apo kundërshtie në këtë aspekt por ajo çka unë desha të pyes Drejtorin e DPUMM është se a ka pasë kërkesë tjetër edhe pse nuk është proceduar. Ne kemi një kërkesë të protokolluar prej Grupit të LVV-së për çështjen që e ceka.

Po e përsërisë sërish, ne e njohim kontributin e secilit që nënkupton edhe kontributin e Fadil Vokrrit dhe ne nuk jemi kundër vendosjes së shtatores së tij, dhe nuk ka nevojë të shtrohet kjo temë në këtë kontekst fare sepse është kontekst jo i qëlluar i diskutimit mbi këtë çështje, por ajo çfarë desha të pyes drejtorin është çfarë ka ndodhë me kërkesën tonë për emërtimin e shëtitores prej parkut të qytetit deri te banesat e “Malësisë” në pjesën afër lumit, kjo është pyetja ime rreth kërkesës së protokolluar prej Grupit të këshilltarëve të LVV-së, për të cilën kemi biseduar, kjo ishte ajo çka dëshirova të pyes jo për çështjen e shtatores së Fadil Vokrrit, në rregull është dhe mendoj që duhet të vendoset dhe të gjejmë një vend të përshtatshëm, por pyetja ishte rreth çështjes tjetër kjo është ajo çfarë thashë dhe që e përsërita.

z.Mehmet Gashi, theksoi, e përkrahi vendosjen e shtatores së Fadil Vokrrit duke qenë e ditur se është një legjendë mirëpo Drejtoria përkatëse apo Ekzekutivi i Komunës duhet të propozoi vendin/lokacionin e vendosjes së shtatores në mënyrë që kjo çështje të mos del në Kuvend për debat. Ne e përkrahim që vendi/lokacioni i vendosjes së shtatores të jetë sa më në qendër të qytetit mirëpo propozimin konkret duhet ta bëjë DPUMM, qoftë një apo dy lokacione e që pastaj Kuvendi të vendos për njërin, mirëpo do të ishte mirë të mos shkojmë në seancë të Kuvendit pa propozim të lokacionit sepse do të humbim kohë pa nevojë rreth kësaj teme.

z.Vendenis Lahu, theksoi, është e rëndësishme që të jetë propozimi për vendosjen e shtatore së Fadil Vokrrit, dhe jo kundër diçka tjetër, kjo është pjesa më e rëndësishme.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Komitetit, theksoi, meqë nuk ka të lajmëruar tjerë për të marrë fjalën unë e hedh në votim propozimin e Drejtorit të DPUMM që kjo temë të hyjë si pikë shtesë e rendit të ditës në KPF, të diskutohet kur t’i vie radha dhe pastaj t’i rekomandohet apo jo Kuvendit për shqyrtim në seancën e radhës.

Sa i përket asaj që kërkoi z.Vendenis Lahu konsideroj se nesër në Kuvend do të shqyrtohet dhe do të vendoset për lokacion, kurse lidhur me atë që z.Mehmet Gashi e tha se është mirë të kemi sot një propozim konkret për lokacion konsideroj se është mirë që të sjellët një propozim vendim për nesër në Kuvend duke ia bashkëngjitur edhe materialet përkatëse rreth kësaj teme, gjegjësisht rreth vendosjes së shtatores e cila sa jam në dijeni është në përfundim e sipër.

Njëzëri, së bashku me rendin e propozuar të ditës u mbështet edhe propozimi i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, dhe atë:

- **Caktimin e lokacionit për vendosjen e Shtatores së Legjendës së futbollit Kosovar Fadil Vokrri** (e cila hynë në pikën 4 të rendit të ditës)

1. Ekstrakte të procesverbaleve nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa e mbajtur më 23 korrik 2020 dhe 29 korrik 2020

z.Vendenis Lahu, theksoi, dua të ripotencojë se në mbledhjen e fundit që kemi mbajtur të Kuvendit, ne kemi lëshuar sallën dhe nuk ka pasë kuorum për vazhdimin e mbledhjes, nuk e di si e keni proceduar dhe vlerësuar ju por sa kam parë unë nuk ish cek që mbledhja është ndërpre për shkak të kuorumit, ndërsa ju keni nxjerrë vendim me 17 asamblastë të pranishëm në sallë, e në bazë të Rregullores së Punës së Kuvendit e cila është në fuqi nuk mund të vazhdoi seanca e Kuvendit kur nuk ka kuorum, ndërsa në seancat e Kuvendit të Komunës së Podujevës, kuorumi ekziston kur janë të pranishëm 18 asamblastë.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Komitetit, sqarim parafolësit z.Vendenis Lahu, kjo çështje që e shtruat tani nuk është pikë e rendit të ditës dhe nuk është kjo seancë e Kuvendit por e KPF-së, andaj ky diskutim është për Kuvend e jo për KPF, ndërsa në procesverbal është e cekur se 19 asamblastë kanë qenë prezent kurse 17 asamblastë kanë votuar.

Në qoftë se dikush nga ju ka ndonjë vërejtje rreth procesverbaleve të mbledhjeve të kaluara të KPF-së urdhëroni nëse jo atëherë i hedh në votim.

Njëzëri u miratuan Ekstraktet e procesverbaleve nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa e mbajtur më 23 korrik 2020 dhe 29 korrik 2020

2. Propozim rregullorja për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Podujevës

- *Propozim Vendim për vënie në diskutim publik*

z.Gëzim Namani, drejtor i DA, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike, ndër të tjera theksoi, ashtu siç keni mund të shihni në materiale kemi përgatitur një propozim të Rregullore për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Podujevës, si dhe propozimin për diskutim publik dhe organizimin e debateve publike lidhur me këtë dokument i cili është një model i përgatitur komfor Udhëzimit Administrativ të MAPL-së nr.02/2019, pra është drafti i parë të cilin e keni para vetës dhe në qoftë se ka dikush diçka lidhur me këtë çështje për ndonjë sqarim eventual urdhëroni, mirëpo kësaj radhe kemi propozim vendimin për diskutim/debat publik që është obligim ligjor për ta mbajtur. Kohëzgjatjen e diskutimit publik dhe datat e debateve me banorë të zonave të caktuara mund ta caktojmë ne këtu së bashku, kurdo që e shohim të arsyeshme, qoftë nga anëtarët e KPF-së qoftë nga ne si Drejtori që mund të dalim me propozim konkret.

Mënyra se si do të mbahet debati publik mbetet ta diskutojmë për shkak se jemi në pandemi dhe duhet të vendosim se a do zhvillojmë debat nëpër lokalitete me numër më të vogël, pastaj për mënyrën e

organizimit dhe çështje tjera mund ti diskutojmë bashkërisht nesër në mbledhjen e Kuvendit dhe në fund të dalim me një zgjidhje dhe të ecim tutje së bashku përpara me këtë rregullore.

Një sqarim për ju, kjo Rregullore është përgatitur sipas numrit të banorëve dhe sipas rregullave neve si Komunë na takojnë 30 këshilla, 6 janë këshilla urbane ku ne kemi shkuar në ndarjen e tyre me kriterin urban të Hartës Zonale që e kemi përgatitur në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit Urban Mbrojtjes së Mjedisit, ndërsa te fshatrat kemi bërë ndarjen në bazë të kriterit kadastral, pra kemi 24 këshilla lokale dhe 6 këshilla urbane. Ky është maksimumi ligjor i këshillave lokale dhe urbane që ne kemi mundur të nxjerrim, e di që ndokund mund të kemi mospajtime rreth tyre por besoj që nesër gjatë debatit në Kuvend do i zgjedhim gjitha ato.

z.Mehmet Gashi, theksoi, e përkrahi këtë propozim rregullorë që të rekomandohet në Kuvend sepse e njëjta duhet të dal në diskutim publik dhe mund të plotësohet pas diskutimit publik. Pastaj ne edhe njëherë kemi mundësi të japim vërejtje, propozimet, sugjerimet dhe plotësim ndryshimet të cilat edhe mund t'i miratojmë, mirëpo kam një vërejtje te neni 4 i kësaj rregulloreje te këshillat lokale urbane rreth përkufizimit ku po thuajse të gjitha këto këshilla janë të ndara në rreth rrotullime dhe udhëkryqe mirëpo këto rreth rrotullime dhe udhëkryqe nuk janë të cekura me emra andaj ndoshta është mirë që nesër në Kuvend të rregullohen këto dhe ne të dimë përkufizimin e rrugëve, që mos të kemi ngatërresa të lagjeve urbane pas miratimit të kësaj Rregulloreje.

z.Gëzim Namani, drejtor i DA, sqarim parafolësit theksoi, nuk e di se a të ka ardh në e-mail shtojca e rregullores në fjalë sepse ato çështje që u cekën i kemi të ndara me rrugë nga DPUMM, ku secila rrugë është e definuar saktë se cilin këshill urban përfshinë, për atë arsye e ceka se këto ndarje janë bërë sipas Hartës Zonale në rrugë për secilën ndarje ku është, nëse nuk e keni shtojcën e rregullores ju kërkojmë ndjesë.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Komitetit, theksoi, nëse ndokush nuk diçka rreth kësaj pike unë e hedh në votim që t'i rekomandohet Kuvendit.

Njëzëri i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim.

3. Propozim Kodi i Etikës për zyrtarët e Komunës së Podujevës

z.Gëzim Namani, drejtor i DA, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike, ndër të tjera theksoi, pranë vetit e kemi një propozim Kod të Etikës për zyrtarët e Komunës së Podujevës, dokument i cili si model është hartuar dhe dërguar të gjitha Komunave nga MPL, ndërsa ne e kemi harmonizuar këtë model sipas specifikave tona si Komunë dhe kemi vepruar njëjtë si të tjerat dhe tani i propozojmë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend sepse është një dokument i domosdoshëm për vlerësimin e Komunave, ndoshta jemi vonuar paksa për ta proceduar një dokument të tillë por kemi pritur që ta kemi një model nga Ministria e Pushtetit Lokal andaj edhe këto janë arsyet pse ky kod është proceduar tani.

Po e përsërisë se është një model Kod i Etikës i hartuar nga MPL për të gjitha Komunitetet e Republikës së Kosovës dhe si i tillë mund të miratohet nga ana juaj si KPF respektivisht si Kuvend i Komunës.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Komitetit, meqë nuk pati të lajmëruar për të marrë fjalën e hedh në votim që ky propozim Kod i Etikës për zyrtarët e Komunës së Podujevës t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim.

Njëzëri i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim

4. Caktimin e lokacionit për vendosjen e Shtatores së Legjendës së futbollit Kosovar Fadil Vokrri

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Komitetit, theksoi, kemi edhe këtë pikë shtesë e cila hyri si propozim i DPUMM e që konsideroj se u diskutua mjaft në hyrje të kësaj mbledhje, andaj nëse ndokush ka diçka për të shtuar urdhëroni nëse jo e hedh në votim që t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim.

Njëzëri i rekomandohet Kuvendit për përfshirje në kuadër të rendit të ditës në pikën 4 për shqyrtim dhe me konstatim që në mbledhjen e Kuvendit të ketë propozim konkret për lokacionin ku do të vendoset shtatorja e Fadil Vokrrit.

Mbledhja përfundoi në orën 10;40

**Procesverbalin e mbajti
Sabedin Namani**

**Nr.01-060/04-0054119/20
Podujevë,
08 shtator 2020**

**Kryesuesi i Komitetit
Fatmir Gashi**